

RAPORT MONITORIMI

**NGRITJA E GJYKATAVE
TË POSAÇME KUNDËR
KORRUPSIONIT DHE KRIMIT
TË ORGANIZUAR
DHE STRUKTURËS
SË POSAÇME SPAK**

Tiranë
(Nëntor 2019)

4



Raport Monitorimi 4

NGRITJA E GJYKATAVE TË POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE STRUKTURËS SË POSAÇME SPAK

Tiranë
(Nëntor 2019)



Ky Raport Monitorimi u përgatit nga Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes në kuadër të projektit: “**Forcimi i informimit dhe pjesmarrjes së publikut në zbatimin e reformës në drejtësi nëpërmjet monitorimit, vlerësimit dhe komunikimit të procesit të ngritjes dhe funksionimit të institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar**”, i mbështetur nga Programi i Reformës në Drejtësi, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.

Mendimet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e donatorit.

Autorë: **Arjan DYRMISHI**, Drejtues i projektit, **Mirsada HALLUNAJ**, Hulumtuese e projektit
Përpunimi Grafik, Ergys Temali

NGRITJA E GJYKATAVE DHE PROKURORISË SË POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

GJETJE DHE REKOMANDIME KRYESORE

QENDRA PËR STUDIMIN E DEMOKRACISË DHE QEVERISJES

Ngritja dhe funksionimi i Gjykatave të Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar (shkallës së parë dhe apelit), dhe Strukturës së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar (ndryshe i quajtur SPAK), përbën një nga komponentët kryesore të reformës në sistemin e drejtësisë.

Për shkak se reforma parashikon një transformim gjithëpërfshirës të të gjitha organeve qeverisëse të sistemit të drejtësisë, si dhe rivlerësimin kalimtar (vetting) të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve, ngritja e Gjykatave të Posaçme dhe SPAK ka qenë e kushtëzuar dhe e ndërlidhur me këto dy procese.

Por më së shumti, ecuria e procesit ka qenë e kushtëzuar nga rivlerësimi kalimtar i anëtarëve gjyqtarë dhe prokurorë të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP) dhe më pas, me rivlerësimin e kandidatëve për SPAK dhe Gjykatat e Posaçme.

Ngritja e KLGJ dhe KLP ishte parashikuar të përfundonte 8 muaj nga hyrja në fuqi e ndryshimeve kushtetuese (gjatë muajit prill 2017), por procesi i rivlerësimit për kandidatët për anëtarë gjyqtarë dhe anëtarë prokurorë në KLGJ dhe KLP filloi në dhjetor të vitit 2017, me hedhjen e shortit për subjektet prioritare, në të cilën u renditën në total 32 kandidatë për të dy Këshillat: 14 kandidatë gjyqtarë për KLGJ dhe 18 kandidatë prokurorë për KLP.

Megjithëse procesi i rivlerësimit të këtyre subjekteve pritej të zhvillohej me ritme të përshpejtuara, zhvillimi i seancave dëgjimore u shoqërua me ritme të ulta dhe shkëputje kohore, duke përfunduar pas rreth tetë muajsh në nëntor 2018.

Ngritja e KLGJ dhe KLP u realizua vetëm në dhjetor të vitit 2018, me një vonesë prej 20 muajsh nga parashikimi fillestar, duke reflektuar gjithashtu edhe në ngritjen e Gjykatave të Posaçme dhe Prokurorisë së Posaçme.

Pas konstituimit, KLGJ dhe KLP filluan menjëherë ushtrimin e kompetencave në drejtim të zbatimit të hapave ligjorë për emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve anëtarë të strukturave të posaçme.

Për shkak se ngritja e Gjykatave të Posaçme është parashikuar të realizohet nëpërmjet një procesi tranzitor të transformimit të Gjykatave të Krimeve të Rënda (Shkallës së Parë dhe Apelit), emërimi i gjyqtarëve të Gjykatave të Posaçme nuk është domosdoshmërisht i ndërlidhur me procesin e rivlerësimit.

Për emërimin e gjyqtarëve aktualë të Gjykatave të Krimeve të Rënda legjislativi ka parashikuar fillimisht emërimin e përkohshëm të tyre në Gjykatat e Posaçme, në rastet kur ndaj tyre ka filluar procesi i rivlerësimit në shkallë të parë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, dhe kur gjyqtarët kanë dorëzuar tek KLGJ deklaratat për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake dhe të familjarëve të afërt.

Të 14 gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda e kanë dhënë pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake. Kështu, ata mund të emërohen në mënyrë të përkohshme sapo Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë të krijohet.

Ndërkohë, nga 11 gjyqtarët e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, 8 prej tyre kanë dhënë pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake dhe të familjarëve të afërt.

Afati i emërimit të përkohshëm të gjyqtarëve aktualë të Gjykatave të Krimeve të Rënda nga KLGJ parashikohej të kryhej brenda muajit shkurt 2019, dy muaj nga krijimi i këtij organi. Por, për shkak se çështjet që janë aktualisht në gjykim nga Gjykatat për Krimet e Rënda dhe që ndiqen penalisht nga Prokuroria për Krimet e Rënda, do të duhet ti kalojnë në kompetencë Gjykatave të Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Prokurorisë së Posaçme në mënyrë të njëkohshme, emërimi i përkohshëm i gjyqtarëve aktualë të Gjykatave të Krimeve të Rënda nuk mund të kryhet.

Ndërkohë, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit filloi procedurat e rivlerësimit për gjyqtarët e Gjykatave të Krimeve të Rënda nëpërmjet shorteve të datave 15 maj 2018 dhe 15 janar 2019. Megjithëse vendimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelit janë vendimtare për emërimin e përhershëm të gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda në Gjykatat e Posaçme, ritmet e këtij procesi për këto gjyqtarë kanë qenë të ulta dhe për rrjedhojë numri i vendimeve dhe emërimeve të tyre ka qenë i vogël.

Në mënyrë të veçantë ky proces ka ecur ngadalë për 14 gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, nga të cilët vetëm 2 gjyqtarë i janë nënshtruar rivlerësimit, njëri prej tyre i konfirmuar në detyrë dhe gjyqtari tjetër i shkarkuar me vendim të KPK-së. Ndërkohë ende nuk është caktuar asnjë datë për zhvillimin e seancave dëgjimore për gjyqtarët e tjerë të kësaj Gjykate.

Ritmet e seancave dëgjimore të zhvilluara nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit kanë qenë të ndryshme për gjyqtarët e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, për 10 prej të cilëve procesi i rivlerësimit ka përfunduar nga 11 gjyqtarë që ka kjo Gjykatë. Në përfundim të vlerësimit, 5 nga këta gjyqtarë janë konfirmuar në detyrë dhe 5 prej tyre janë shkarkuar.

Në ndryshim nga parashikimi i emërimit të përkohshëm të gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda në Gjykatat e Posaçme, kandidatët për prokuror në Prokurorinë e Posaçme duhet që më parë të jenë konfirmuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

Për këtë arsye edhe veprimtaria e Këshillit të Lartë të Prokurorisë ka qenë më e ngjeshur gjatë periudhës që nga krijimi i këtij organi në datën 19 dhjetor 2018.

Sipas përcaktimit të Kushtetutës, Prokuroria e Posaçme do të duhet të përbëhet nga të paktën 10 prokurorë, të cilët do të duhej të ishin emëruar brenda dy muajve nga krijimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Megjithatë ky afat nuk u arrit për shkak se thirrjes së parë për aplikim të shpallur nga KLP në 7 janar 2019, iu përgjigjën vetëm 15 prokurorë.

Nga ana tjetër po në janar 2019, KLP vendosi se Prokuroria e Posaçme do të përbëhej nga 15 prokurorë duke e bërë kështu më të vështirë arritjen e numrit të domosdoshëm për ngritjen e Prokurorisë së Posaçme.

Në periudhën që nga janari deri në fund të tetorit 2019, KLP ka realizuar një sërë procesesh të rëndësishme në drejtim të ngritjes së Prokurorisë së Posaçme siç janë miratimi i Rregullores mbi kriteret dhe procedurën për emërimin e prokurorëve në këtë organ, shqyrtimi i listës së aplikantëve që plotësonin kushtet ligjore për të vazhduar me procesin e vlerësimit, si dhe vlerësimin profesional të 25 kandidatëve të cilët plotësuan kushtet ligjore

për të vazhduar garën për prokurorë të posaçëm, pas përmbylljes së afatit të dytë të aplikimeve në datën 21 shkurt 2019.

Shqyrtimi i kandidaturave u krye sipas Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimet të Organizuar”, të miratuar nga KLP në 19 mars 2019. Sipas po kësaj Rregulloreje, në 16 korrik 2019 KLP përfundoi vlerësimin profesional të kandidatëve për prokurorë të posaçëm.

Pavarësisht përfundimit të këtij procesi dhe renditjes së kandidatëve, për emërimin e 15 prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme duhet të jetë kryer edhe procesi i rivlerësimit me vendim të fromës së prerë. Me përfundimin e vlerësimit profesional të kandidatëve për prokurorë të posaçëm edhe Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA), kanë përsheptuar ritmet procesit të rivlerësimit të prokurorëve kandidatë për në Prokurorinë e Posaçme, veçanërisht gjatë muajve qershor-korrik, duke zhvilluar 8 seanca dëgjimore me prokurorë kandidatë për në Prokurorinë e Posaçme. Ndërkohë në muajt në vijim këto ritme kanë qenë tepër të ngadalta.

KPK po vijon me procesin e rivlerësimit të 15 kandidatëve në garë për ngritje në detyrë në Prokurorinë e Posaçme. Deri në fund të muajit tetor 2019, nga KPK janë konfirmuar në detyrë 10 kandidatë, por për 2 prej tyre vendimi i KPK është ankimuar në KPA. Një kandidat është shkarkuar nga detyra, ndërkohë që për 4 kandidatët e tjerë të cilët janë ende në proces rivlerësimi, akoma nuk janë përcaktuar datat për zhvillimin e seancave dëgjimore.

Në këtë fazë, vijimi i mëtejshëm i procesit të ngritjes së Gjykatave dhe Prokurorisë së Posaçme, varet nga ritmet e rivlerësimit kalimtar të kandidatëve për prokurorë dhe gjyqtarë në këto institucione dhe rezultatet e rivlerësimit.

Së pari, nuk ka ndonjë parashikim për kohën e kryerjes së seancave dëgjimore për 4 kandidatët e tjerë për ngritje në detyrë në Prokurorinë e Posaçme. Meqenëse për ngritjen e Prokurorisë e Posaçme duhen jo më pak se 10 prokurorë, dhe për shkak se nga 10 kandidatët e konfirmuar nga KPK, 2 vendime janë ankimuar në KPA, koha se kur do të plotësohet numri 10 prokurorë i parashikuar nga Kushtetuta për ngritjen e Prokurorisë së Posaçme, mbetet e papërcaktuar.

Përkundrajt këtij konteksti, në mbledhjen e mbajtur në datën 25 tetor 2019 KLP ka vendosur që brenda muajit nëntor të kryejë procedurat e emërimit të 8 prokurorëve të posaçëm të cilët janë konfirmuar në të dyja shkallët e rivlerësimit.

Së dyti, për shkak të ritmeve dhe rezultateve të rivlerësimit të gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda (shkallës së parë dhe apelit), në këtë fazë është e pamundur arritja e numrit kushtetues për themelimin e gjykatave të posaçme, pasi Gjykata e Posaçme e shkallës së parë duhet të përbëhet nga së paku 16 gjyqtarë, ndërsa Gjykata e Posaçme e Apelit duhet të përbëhet nga së paku 11 gjyqtarë.

Nga 25 gjyqtarët e Gjykatave të Krimeve të Rënda (shkallës së parë dhe apelit) mbeten akoma 13 prej tyre, të cilët duhet t'i nënshtrohen procesit të rivlerësimit.

Si përfundim, për adresur problematikat që lindin nga numri i pamjaftueshëm i gjyqtarëve duhet që KPK dhe KPA të përsheptojnë ritmet e rivlerësimit kalimtar të kandidatëve për emërim në Gjykatat e Posaçme pasi rezultatet e vendimeve të marra për gjyqtarët aktualë do të përcaktojnë numrin e vendeve vakante në këto Gjykata.

Kjo do t'i mundësojë KLGJ shpalljen e vendeve vakante për të plotësuar numrin e nevojshëm të gjyqtarëve të parashikuar në ligj për ngritjen e Gjykatave të Posaçme.

Duke theksuar se krijimi i Gykatave të Posaçme dhe Prokurorisë së Posaçme duhet të ndodhë në të njëjtën kohë, ç'ka do të thotë se edhe nëse plotësohet numri i prokurorëve kandidatë për anëtarë të Prokurorisë së Posaçme, funksionimi i saj do të mbetet pezull deri në krijimin e Gykatave të Posaçme.

Ngritja e KLGJ dhe KLP

Sipas Ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët duhet të kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit. Për zgjedhjen e anëtarëve gjyqtarë dhe prokurorë në KLGJ dhe KLP është i detyrueshëm konfirmimi në detyrë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

Por, për shkak të vonesave në ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, procesi i kryerjes së vlerësimit kalimtar të kandidatëve për anëtarëve gjyqtarë dhe prokurorë në KLGJ dhe KLP gjithashtu u realizua me vonesë. KPK zyrtarisht e filloi veprimtarinë në muajin tetor 2017, me inagurimin e mjediseve të punës.¹

Për pasojë, edhe ngritja e KLGJ dhe KLP, e cila ishte parashikuar të përfundonte 8 muaj nga hyrja në fuqi e ndryshimeve kushtetuese (gjatë muajit prill 2017),² u realizua vetëm në dhjetor të vitit 2018, me një vonesë prej 20 muajsh nga parashikimi fillestar.

Por vonesat vazhduan edhe mbas fillimit të veprimtarisë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Me shpalljen e listës për subjektet e përparësisë të muajit dhjetor 2017, u renditën në total 32 kandidatë për të dy Këshillat: 14 kandidatë gjyqtarë për KLGJ dhe 18 kandidatë prokurorë për KLP. Megjithëse procesi i rivlerësimit të këtyre subjekteve pritej të zhvillohej me ritme të përshpejtuara, zhvillimi i seancave dëgjimore u shoqërua me ritme të ulta dhe shkëputje kohore.

Vonesat në ngritjen e KLGJ dhe KLP janë reflektuar gjithashtu edhe në ngritjen e Gykatave të Posaçme dhe Prokurorisë së Posaçme.

Këshilli i Lartë Gjyqësor

Këshilli i Lartë Gjyqësor është organi kolegjal më i rëndësishëm qeverisës i sistemit gjyqësor, i cili ka në përbërje 11 anëtarë, 6 prej të cilëve gjyqtarë nga të gjitha nivelet e pushtetit gjyqësor (3 gjyqtarë të shkallës së parë dhe së paku 1 prej tyre gjyqtar në një gjykatë të shkallës së parë jashtë Tiranës; 2 gjyqtarë të apelit dhe së paku 1 prej tyre gjyqtar në një gjykatë të apelit jashtë Tiranës dhe 1 gjyqtar nga Gjykatën e Lartë) dhe 5 anëtarë jo gjyqtarë, të cilët u zgjedhën nga Kuvendi i Shqipërisë në votimin e tretë të datës 8 shkurt 2018.³

¹ Inagurohet godina, institucionet e vetingut nisin zyrtarisht punën. 30 tetor 2017. <https://www.reporter.al/inagurohet-godina-institucionet-e-vetingut-nisin-zyrtarisht-punen/>

² Ligji 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Nenet 276-280

³ Kuvendi i Shqipërisë, Vendim Nr. 18/2018 Për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas Ligjit 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”: <http://qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%2019/VENDIM%20KUVENDI%20nr.%2018-2018,%20date%208.2.2018.pdf>

KLGJ parashikohej të krijohej 8 muaj nga hyrja në fuqi e ndryshimeve kushtetuese të miratuara në korrik të vitit 2016.⁴ Por procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve kandidatë për të qenë pjesë e këtij organi filloi në dhjetor të vitit 2017, me hedhjen e shortit për subjektet prioritare,⁵ dhe përfundoi në nëntor të vitit 2018.⁶

Vonesat, erdhën kryesisht edhe si rezultat i ritmit të ngadaltë të zhvillimit të seancave dëgjimore të gjyqtarëve kandidatë për të qenë pjesë e këtij organi.

Në muajin janar 2017, thirrjes fillestare për paraqitjen e shprehjes së interesit për të plotësuar 6 vendet vakante për pozicionin e anëtarit të KLGJ u përgjigjën 14 gjyqtarë. Në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar, 9 gjyqtarë u konfirmuan në detyrë, 4 u shkarkuan dhe 1 gjyqtar i kësaj liste u dorëhoq.⁷

Në muajin korrik 2018 Gjykata e Lartë ripublikoi thirrjen për shprehje interesi për gjyqtarët e gjykatave të apelit jashtë Tiranës për të paraqitur kandidaturën për tu zgjedhur në pozicionin e anëtarit të KLGJ, pozicion ky i paplotësuar edhe pas përfundimit të rivlerësimit të kandidatëve aplikantë në listën prioritare. Por kësaj thirrje nuk iu përgjigj asnjë gjyqtar dhe për pasojë në muajin gusht 2018 Gjykata e Lartë e rishpalli thirrjen.⁸

Në 13 shtator 2018 Gjykata e Lartë shpalli listën përfundimtare të kandidatëve gjyqtarë për në Këshillin e Lartë Gjyqësor, duke i hapur rrugë procesit për zgjedhjen e tyre.⁹ Në 12 dhjetor 2018 me kërkesë të kryetarit të Gjykatës së Lartë u zhvillua Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve,¹⁰ e cila nëpërmjet votimit zgjodhi 6 anëtarët e rinj të Këshillit të Lartë Gjyqësor¹¹ duke sjellë edhe ngritjen e këtij organi.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë

Këshilli i Lartë i Prokurorisë është organi më i lartë qeverisës i prokurorisë dhe ka një strukturë të njëjtë në konceptim më atë të KLGJ duke patur në përbërje 11 anëtarë, prej të cilëve 6 anëtarë prokurorë dhe 5 anëtarë jo-prokurorë.

Anëtarët prokurorë të KLP zgjidhen nga Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve ku përfshihen: 3 prokurorë të shkallës së parë dhe së paku 1 prej tyre prokuror në një prokurori

⁴ Ligj Nr. 76/2016 datë 22.7.2016. Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Neni 179/5, në vijim Kushtetuta e Shqipërisë

⁵ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK), Shorti për subjektet e listës së përparësisë: <http://kpk.al/njoftim/>

⁶ Arjan Dyrmishi dhe Mirsada Hallunaj. “Raport Monitorimi mbi Ecurinë e Procesit për Ngritjen e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe Gjykatave të Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar”, fq. 31. CSDG, Nëntor 2018.

http://csdgalbania.org/sq/wp-content/uploads/2018/12/SPAK_RAPORTI_FINAL04_web.pdf

⁷ Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, SPAK Monitor Nr.2, Shtator-Nëntor 2018:

http://csdgalbania.org/sq/wp-content/uploads/2018/12/newsletter_spak2_03.pdf

⁸ Gjykata e Lartë, Njoftim – Rishpallje e thirrjes për paraqitjen e shprehjes së interesit nga gjyqtarët e Gjykatave të Apelit jashtë Tiranës për Pozicionin e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor: http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Rishpallje_e_thirrjes_per_paraqitjen_e_shprehjes_se_interesit_nga_gjyqtaret_e_gjykatave_te_apelit_jashte_Tiranes_per_pozicionin_e_anetarit_te_5317_1.php

⁹ Gjykata e Lartë, Njoftim për shpalljen e listës përfundimtare të kandidatëve gjyqtarë për Këshillin e Lartë Gjyqësor:

http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Rezultatet_e_Kerkimit_2254_1.php?search=NJOFTIM+P%C3%8BR+SH_PALLJEN+E+LIST%C3%8BS+P%C3%8BRFUNDIMTARE+T%C3%8B+KA

¹⁰ Gjykata e Lartë, Njoftim, Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve, datë 12.12.2018: http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Mbledhja_e_Pergjithshme_e_Gjyqtareve_date_12_12_2018_5450_1.php

¹¹ Gjykata e Lartë, Vendim Nr. 242, datë 12.12.2018 Për shpalljen e kandidatëve fitues për anëtarë gjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor: http://www.gjykataelarte.gov.al/web/untitled_1885.pdf

pranë gjykatës të shkallës së parë jashtë Tiranës; 2 prokurorë të prokurorive pranë gjykatave të apelit dhe së paku 1 prej tyre prokuror në një prokurori pranë një gjykate apeli jashtë Tiranës; 1 prej tyre prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

Fillimisht për të qenë pjesë e Këshillit të Lartë të Prokurorisë aplikuan 19 prokurorë, nga Prokuroria e Përgjithshme, prokuroritë e rretheve gjyqësore dhe prokuroria e Tiranës si edhe prokurorë të Prokurorive të Krimeve të Rënda.¹² Kandidatët për në KLP u përfshinë në listën prioritare të rivlerësimit nga KPK.¹³ Procesi i rivlerësimit të 19 prokurorëve u zhvillua gjatë periudhës prill-nëntor 2018, duke zgatur rreth 7 muaj, përfshirë edhe rastet e mos plotësimit të vendeve vakante dhe rishpalljen e thirrjeve.¹⁴

Në përfundim të procesit 10 prokurorë u konfirmuan në detyrë nga KPK, ndërkohë që 8 prej tyre nuk arritën të kalonin procesin e rivlerësimit.¹⁵ Rreth 45% e kandidatëve për në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, të cilët kaluan vetting-un u vlerësuan me nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, ndërkohë që rreth 50% apo gjysma e vendimeve për 10 subjektet e konfirmuara nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit u ankuan në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (KPA).¹⁶

Me përfundimin e rivlerësimit për të gjitha subjektet kandidatë në KLP, Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve e zhvilluar në 11 dhjetor 2018,¹⁷ zgjodhi nëpërmjet votimit 6 anëtarët prokurorë,¹⁸ të cilët ju bashkuan 5 anëtarëve jo-prokurorë të zgjedhur nga Kuvendi i Shqipërisë në 8 shkurt të vitit 2018.¹⁹

Mbledhja e parë e KLP, e cila solli edhe konstituimin e këtij organi u zhvillua në datën 19 dhjetor 2018.²⁰ Gjatë kësaj seance të parë, Këshilli zgjodhi kryetarin e tij dhe zv/kryetarin si dhe përcaktoi mandatet e secilit anëtar të këtij institucioni (Aneks V).

Ngritja e Gjykatave të Posaçme

Me konstituimin e KLGJ filloi ushtrimi i kompetencave për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda (GJKR) në Gjykatat e Posaçme.

¹² Prokuroria e Përgjithshme, Shpallen kandidatët zyrtarë për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, dt. 24.01.2017: http://www.pp.gov.al/web/Shpallen_kandidatet_zyrtare_per_Keshillin_e_Larte_te_Prokurorise_1040_1.php#.XcmZJtVKgdU

¹³ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK), Shorti për subjektet e listës së përparësisë: <http://kpk.al/2017/12/12/njoftim/>

¹⁴ Prokuroria e Përgjithshme, “Thirrje për paraqitjen e shprehjes së interesit për kandidatë në Këshillin e Lartë të Prokurorisë – Prokurorëve pranë Gjykatave të Apelit”, 12.10.2018: http://www.pp.gov.al/web/Rezultatet_e_Kerkimit_237_1.php?search=thirrje#.XJplL1VKgdU

¹⁵ Kandidati Arta Marku meqenëse u zgjodh Prokuror i Përgjithshëm, i përkohshëm, nuk e vazhdoi garën për anëtar i KLP

¹⁶ Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, SPAK Info – Buletin Informativ Nr.2, fq. 5-6 http://csdgalbania.org/sq/wp-content/uploads/2018/12/newsletter_spak2_03.pdf

Institucioni i Komisionerëve Publikë (IKP), Ankime: <http://ikp.al/ankime/>

¹⁷ Procesverbal i procesit të votimit nga Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve për zgjedhjen e anëtarëve prokurorë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë: http://www.pp.gov.al/web/procesverbali_1428.pdf

¹⁸ Vendim për rezultatit e zgjedhjeve dhe shpalljen e fituesve: http://www.pp.gov.al/web/vendim_1429.pdf

¹⁹ Kuvendi i Shqipërisë, Vendim Nr. 19/2018 Për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas Ligjit 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”: <http://qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%2019/VENDIM%20KUVENDI%20nr.%2019-2018.%20date%208.2.2018.pdf>

²⁰ Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), Krijohet Këshilli i Lartë i Prokurorisë, 11 dhjetor 2018: <http://kpl.al/index.php/2018/12/22/seanca-plenare-1/>

Krijimi i Gjykatave të Posaçme do të realizohet bazuar në një proces gradual të transformimit të Gjykatave ekzistuese të Krimeve të Rënda (Gjykata e Shkallës së Parë dhe Gjykata e Apelit) nëpërmjet emërimit të gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda në Gjykatat e Posaçme KKKO.

Megjithatë, përpara emërimit dhe caktimit në detyrë në Gjykatat e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, gjyqtarët e Gjykatave të Krimeve të Rënda do të duhet të plotësojnë kushtet e sigurisë, të cilat përfshijnë:²¹

1. kontrollin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës;
2. dhënien e pëlqimit për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake; si dhe
3. dhënien e pëlqimit prej anëtarëve të afërt të familjes për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake.

Në lidhje me plotësimin e kushtit të parë, i cili i referohet kontrollit të pasurisë dhe figurës, organi përgjegjës për verifikimin e këtij kriteri do të jetë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.²² Ndërkohë, në lidhje me dorëzimin e deklaratave respektive për kontrollin e llogarive bankare dhe telekomunikimeve vetjake të gjyqtarëve dhe të familjarëve të afërt të tyre do të jetë Këshilli i Lartë Gjyqësor, i cili do të shërbejë si organ emërtese për depozitimin e këtyre deklaratave.

Gjyqtarët në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda qëndrojnë në detyrë në pozicionin e tyre respektiv deri në momentin e krijimit të Gjykatave të Posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar.²³

Në funksion të transformimit gradual të Gjykatave të Krimeve të Rënda dhe kalimit të gjyqtarëve të këtyre Gjykatave në Gjykatat e Posaçme, legjislacioni ka parashikuar fillimisht emërimin e përkohshëm dhe më pas emërimin e tyre të përhershëm.

Emërimi i përkohshëm

Emërimi i përkohshëm i gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda në Gjykatat KKKO është parashikuar për të krijuar mundësinë e vijmësisë së funksionimit të këtyre institucioneve dhe për të respektuar të drejtën e të pandehurve për një gjykim të drejtë.

Emërimi i përkohshëm i gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda në Gjykatat e Posaçme realizohet nga KLGJ, i cili cakton gjyqtarin përkohësisht në nivelin përkatës në Gjykatën e Posaçme në rastet kur:

- gjyqtarët japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake;²⁴
- anëtarët e afërt të familjes japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake;

²¹ Ligji Nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, Neni 6/1, në vijim: Ligji për institucionet kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar

²² Ligji për institucionet kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Neni 57/11

²³ Ligji Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Neni 162/1, në vijim: Ligji për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve

²⁴ Ligji për institucionet kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar”, Neni 6/1-4

- ndaj gjyqtarit në detyrë në Gjykatën e Krimeve të Rënda ka filluar procesi i rivlerësimit në shkallë të parë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendim të formës së prerë.²⁵

Gjyqtarët në detyrë në Gjykatat e Krimeve të Rënda nuk mund të kalojnë dhe të emërohen në Gjykatat e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në rastet kur:

- ndaj gjyqtarëve janë marrë masa disiplinore në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar;²⁶
- në rastin e përfundimit të statusit të magjistratit;²⁷
- apo në rastin kur gjyqtarët në detyrë pranë gjykatave të krimeve të rënda apo familjarët e tyre të afërt nuk pranojnë të japin pëlqimin për rishikimin periodik të llogarive të tyre financiare dhe telekomunikimeve vetjake.²⁸

Emërimi i përkohshëm i gjyqtarëve u parashikua të përfundonte dy javë pas krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor,²⁹ organ i cili u konstitua në 20 dhjetor 2018 duke sjellë që afati i emërimit të përkohshëm të gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda të kishte përfunduar brenda 20 shkurtit 2019.

Këshilli i Lartë Gjyqësor vetëm pak ditë pas konstitutimit të tij, ka filluar procedurat ligjore në drejtim të ngritjes së Gjykatave të Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.³⁰

Në përputhje me procedurat e përshkruara më lart, të gjithë gjyqtarët (14) e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda³¹ kanë pranuar të japin pëlqimin për kufizimin e privatësisë, ndërkohë 8 nga 11 gjyqtarë të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda kanë pranuar të japin pëlqimin dhe dorëzojnë deklaratat respektive.³²

Emërimi i përhershëm

Emërimi i përhershëm i gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda në Gjykatat e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar kryhet nga KLGJ, i cili cakton në mënyrë të përhershme gjyqtarët në detyrë në Gjykatën e Posaçme, me kërkesë të tyre dhe nëse plotësohen të gjitha kushtet ligjore si më poshtë:

- gjyqtari kalon me sukses procesin e rivlerësimit;
- gjyqtari përmbush kriteret për ngritjen në detyrë;³³

²⁵ Ligji për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, Neni 162/3

²⁶ Ligji 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Kreu VII, Nenet 56-61

²⁷ Ligji për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, Pjesa III, Kreu VIII

²⁸ Ligji për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, Neni 162/1-5

²⁹ Ligji për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, Neni 162/3

³⁰ Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), Vendim Nr.9, datë 27.12.2019 “Mbi nisjen e procedurës për caktimin e përkohshëm të gjyqtarëve të Gjykatave për Krimet e Rënda në Gjykatat e Posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar”, <http://www.klgj.al/vendime/vendim-nr-9-dat%C3%AB-27-12-2019>

³¹ Gjyqtari në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Dritan Hallunaj është zgjedhur anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor nga Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve, datë 12 dhjetor 2018.

³² Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), Raporti "Mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2018",

<http://www.klgj.al/media/k2/galleries/njofitime/Raporti%20Vjetor%20KLGJ%202018%20-shqip%20version%20perfundimtar.pdf>

³³ Ligji për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, Neni 47

- gjyqtari, si dhe familjarët e afërm të tij japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake.

	Emërimi i përkohshëm (Shkurt 2019)		Emërimi i përhershëm (Në proces)
Gjyqtari:	Së bashku me familjarët e afërm të tij japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake;	Gjyqtari:	Kalon me sukses vetting-un;
	Ndaj gjyqtarit në detyrë në Gjykatën e Krimeve të Rënda ka filluar procesi i rivlerësimit në shkallë të parë nga KPK		Përmbush kriteret për ngritjen në detyrë;
			Së bashku me familjarët e afërm të tij japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake

Tabela 1: Kriteret ligjore për emërimin e përkohshëm dhe të përhershëm të gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda në Gjykatat e Posaçme KKKO

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit filloi procedurat e rivlerësimit për gjyqtarët e Gjykatave të Krimeve të Rënda nëpërmjet shorteve të datave 15 maj 2018³⁴ dhe 15 janar 2019.³⁵ Megjithëse vendimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelit (për rastet e ankimuar) janë vendimtare për emërimin e përhershëm të gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda në Gjykatat e Posaçme, ritmet e këtij procesi për këto gjyqtarë kanë qenë të ulta dhe për rrjedhojë numri i vendimeve dhe emërimeve të tyre ka qenë i vogël.

Në mënyrë të veçantë ky proces ka ecur ngadalë për 14 gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, nga të cilët vetëm 2 gjyqtarë i janë nënshtruar rivlerësimit, njëri prej tyre i konfirmuar në detyrë dhe gjyqtari tjetër i shkarkuar me vendim të KPK-së. Ndërkohë ende nuk është caktuar asnjë datë për zhvillimin e seancave dëgjimore për gjyqtarët e tjerë të kësaj Gjykate.


Ritmet e seancave dëgjimore të zhvilluara nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit kanë qenë të ndryshme për gjyqtarët e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, për 10 prej të cilëve procesi i rivlerësimit ka përfunduar nga 11 gjyqtarë që ka kjo Gjykatë. Problematike mbeten vendimet në për këta gjyqtarë, pasi gjysma e tyre janë shkarkuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërkohë që 3 prej vendimeve janë ankimuar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit.³⁶

³⁴ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK), Njoftim 16/05/2018, <http://kpk.al/njoftim-15/>

³⁵ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK), Njoftim 16/01/2019, <http://kpk.al/njoftim-100/>

³⁶ Shiko Aneks I

Ritmet e Seancave Dëgjimore për gjyqtarët e Gjykatave të
Krimeve të Rënda
(Korrik 2018 - Nëntor 2019)



Grafik 1: Ritmet e Seancave Dëgjimore për gjyqtarët e Gjykatave të Krimeve të Rënda (Korrik 2018 - Nëntor 2019), Burimi: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, (www.kpk.al)

Ngritja e Prokurorisë së Posaçme

Vlerësimi për plotësimin e kushteve ligjore i kandidatëve

Menjëherë pas konstituimit KLP publikoi thirrjen e parë për fillimin e procedurave për plotësimin e 15 vendeve vakante për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme, nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.³⁷ Përveç kushteve të detyrueshme ligjore sipas legjislacionit në fuqi KLP miratoi edhe kritere shtesë të detyrueshme për tu plotësuar nga kandidatët për prokurorë në SPAK.³⁸

Nëpërmjet të njëjtit vendim, Komisioni i Përhershëm për Zhvillimin e Karrierës pranë KLP u ngarkua me hartimin e draft rregullores për procedurat dhe kriteret shtesë për përzgjedhjen e anëtarëve të SPAK si edhe me ndjekjen dhe zbatimin e procedurave paraprahe për plotësimin e kushteve nga kandidatët.³⁹

Megjithëse gjatë dy javëve të para vetëm 2 kandidatë shprehën interesin e tyre për të qenë pjesë e SPAK, me përfundimin e afatit të fazës së parë të aplikimeve në datën 6 shkurt 2019, 15 prokurorë në total dorëzuan dokumentacionin e përcaktuar nga KLP për të qenë pjesë e Prokurorisë së Posaçme.⁴⁰

Në përmbyllje të kësaj faze, ndërmjet anëtarëve të KLP pati diskutime dhe mendime të ndryshme në drejtim të përcaktimit të një afati tjetër me qëllimin nxitjen e prokurorëve kandidatë potencialë dhe me përvojë për të konkurruar në organin më të rëndësishëm të hetimit në vend, duke sjellë miratimin me 10 vota pro dhe 1 kundër për një shtyrje dy javore të aplikimeve të prokurorëve për 15 vendet vakante në Prokurorinë e Posaçme.⁴¹

Afati i ri i aplikimeve i vendosur deri në datë 21 shkurt 2019 solli si rezultat edhe shtyrjen e emërimit të prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme, e parashikuar të përfundonte brenda dy muajve nga krijimi i KLP, specifikisht brenda muajit shkurt 2019. Me mbylljen e afatit të aplikimit u renditën në total 28 prokurorë, kandidatë për ngritje në detyrë në Prokurorinë e Posaçme.⁴²

Me përfundimin e afatit të dytë të aplikimeve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme KLP filloi procedurat për vlerësimin paraprak të plotësimin të kushteve ligjore nga 28 prokurorët në garë.

Procedura e vlerësimin paraprak u krye edhe në përputhje me Rregulloren tranzitore “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar” të miratuar në mars 2019.⁴³

³⁷ Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Vendim Nr. 10/1, datë 07 janar 2019 “Për shpalljen e vendeve vakante në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar”: <https://klp.al/wp-content/uploads/2019/03/Nr.10.1-Dat%C3%AB-07.01.2019-.pdf>

³⁸ Po aty, Neni 2

³⁹ Po aty, Neni 3


⁴⁰ Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, SPAK Info, Nr. 3 – Shkurt 2019, faqe 2-3: <http://csdgalbania.org/sq/wp-content/uploads/2019/02/SPAK-Info-3.pdf>

⁴¹ Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Seanca Plenare Nr. 5: <https://klp.al/2019/02/06/seanca-plenare-nr-5/>

⁴² Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Lista e Aplikimeve për SPAK: <https://klp.al/wp-content/uploads/2019/02/lista-e-aplikimeve-per-SPAK.pdf>

⁴³ Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Seanca Plenare Nr. 8: <https://klp.al/2019/03/19/seanca-plenare-nr-8/>

Komisioni i Posaçëm i ngritur sipas parashikimeve të Rregullores përfundoi procesin e shqyrtimit paraprak dhe nga 28 kandidatë, të cilët shprehën interes për të qenë pjesë e Prokurorisë së Posaçme, u kualifikuan për të vazhduar garën 25 prej tyre.^{44 45 46 47}



Grafik 2: Numri i kandidatëve për prokurorë të posaçëm gjatë Fazës së I dhe të II të aplikimeve

Vlerësimi profesional i kandidatëve

Rregullorja e miratuar nga KLP parashikon kriteret për vlerësimin profesional të prokurorëve kandidatëve për ngritje në detyrë në Prokurorinë e Posaçme. Komisioni i Posaçëm i KLP, i krijuar në përputhje me parashikimet e Rregullores, filloi nga puna gjatë muajit prill 2019 shqyrtimin e dosjeve të 25 kandidatëve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme duke u bazuar në vlerësimin e dy kriterëve kryesore për të cilat u aplikua një sistem pikëzimi dhe sipas metodologjisë së miratuar nga KLP.^{48 49}

Kriteri i parë u bazua në vlerësimin e performancës për dy vitet e fundit të kandidatit. Ndërsa kriteri i dytë u bazua në vlerësimin e kriterëve të posaçme etike dhe profesionale, të përbëra nga: 1) Aftësitë e treguara në hetim, në ndjekjen penale dhe në konfiskim dhe 2)

Vendim, Nr. 51, datë 19.3.2019 Për miratimin e Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar”, <https://klp.al/wp-content/uploads/2019/04/Nr.51-Dat%C3%AB-19.03.2019.pdf>

⁴⁴ Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Seanca Plenare Nr. 10: <http://klp.al/2019/04/01/seanca-plenare-nr-10/>

⁴⁵ Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Seanca Plenare Nr. 11: <http://klp.al/2019/04/05/seanca-plenare-nr-11/>

⁴⁶ Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Vendim Nr. 57, datë 05.04.2019 “Për miratimin e listës me emrat e kandidatëve për prokurorë pranë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar të cilët plotësojnë kushtet ligjore pas vlerësimit paraprak”: <http://klp.al/wp-content/uploads/2019/04/Nr.57-Dat%C3%AB-05.04.2019.pdf>


⁴⁷ Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Vendime datë 05.04.2019: <http://klp.al/2019/04/05/vendime-date-05-04-2019/>

⁴⁸ Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), Metodologjia e punës së Komisionit të Posaçëm për vlerësimin e kandidatëve për Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar: <https://klp.al/wp-content/uploads/2019/05/METODOLOGJIA-P%C3%8BR-VLER%C3%8BSIMIN-E-KANDIDAT%C3%8BVE-T%C3%8B-SPAK.pdf>

⁴⁹ Arjan Dyrmishi dhe Mirsada Hallunaj. Raport Monitorimi 2 – “Emërimi i Gjyqtarëve në Gjykatat e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe Përzgjedhjen e Prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar”, Aneks III & IV, CSDG, Prill 2019: http://csdgalbania.org/sq/wp-content/uploads/2019/04/raport_monitorimi2_SPAK_03.pdf


Vendosmëria e treguar në përballimin e vështirësive, presioneve e rreziqeve dhe integriteti (Grafik 3 dhe 4).

Pas përfundimit të këtyre fazave, Komisionit të Posaçëm njoftoi KLP duke vendosur në dispozicion të anëtarëve kopje të vlerësimeve të shkruara, dokumentet mbështetëse si edhe një përmbledhje të rezultateve të vlerësimit. Bazuar në këto propozime, KLP ka vendosur për shkallën e vlerësimit për secilin kandidat dhe secilin kriter. Pas vendosjes së shkallës së vlerësimit për secilin kandidat dhe pikëve për secilin prej kriterëve (sipas hapësirës së pikëzimit), kandidatët janë renditur sipas numrit të pikëve që ato kanë grumbulluar.



**Shkallët e Vlerësimit për Kriterin e Performancës
(2 vlerësimet e fundit profesionale)**

Grafik 3: Shkallët e Vlerësimit për Kriterin e Performancës (2 vlerësimet e fundit profesionale), për kandidatët prokurorë të posaçëm



I. Aftësitë e treguara në hetim, në ndjekjen penale dhe në konfiskim

II. Vendosmëria e treguar në përballimin e vështirësive, presioneve e rreziqeve dhe integriteti

Grafik 4: Shkallët e Vlerësimit për Kriteret e Posaçme Etike dhe Profesionale, për kandidatët prokurorë të posaçëm

Ndërkohë, gjatë periudhës mars-korik 2019, KLP ka miratuar edhe raportet për analizimin e aftësive profesionale të kandidatëve në garë (Tabela 2).

Prokurorët kandidatë për në Prokurorinë e Posaçme	Periudha kohore e miratimit të Raporteve për Analizimin e Aftësive Profesionale nga KLP					
	06.03.2019	15.04.2019	13.05.2019	24.05.2019	12.06.2019	16.07.2019
Altin Dumani Enkeleda Millonai	Miratuar					
Doloreza Musabelliu Elizabeta Imeraj Ened Nakuçi Eugen Beçi Manjola Kajana Vladimir Mara		Miratuar				
Behar Dibra Klodjan Braho			Miratuar			
Edvin Kondili				Miratuar		
Anita Jella Dorina Bejko Elida Kaçkini Enkeleda Xhengo Ndini Tavani					Miratuar	
Maksim Sota						Miratuar

Tabela 2: Periudha kohore e miratimit të Raporteve për Analizimin e Aftësive Profesionale nga KLP për prokurorët kandidatë në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Burimi: Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP): www.klp.al

Gjatë muajit korrik (8-12 korrik 2019) KLP ka vijuar me procesin e intervistimit të 22 kandidatëve në garë për ngritje në detyrë në Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar.⁵⁰ KLP i ka ndarë kandidatët sipas një rendi emëror në përputhje me kalendarin e intervistave të publikuar në faqen zyrtare të institucionit.⁵¹

Me përfundimin e procesit të intervistave KLP ka vijuar me llogaritjen e pikëve të marra nga secili kandidat. Në mbledhjen e zhvilluar në datën 16 korrik, KLP ka miratuar listën me renditjen e 15 kandidatëve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar (Tabela 3).⁵² Emrat janë listuar bazuar në kriteret, aftësitë profesionale, duke përfshirë hetimin e çështjeve të rëndësishme dhe kontributin që secili prej kandidatëve ka dhënë në sistemin e drejtësisë.⁵³

⁵⁰ Prokurori Eugen Beci është përjashtuar nga gara për ngritje në detyrë në Prokurorinë e Posaçme si rezultat i vendimit të KPK. Ndërsa prokurorët Vatë Staka dhe Shkëlzen Cenaj kanë dhënë dorëheqjen nga gara.

⁵¹ Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), Njoftim, datë 27.06.2019: <http://klp.al/wp-content/uploads/2019/06/Kalendari-i-zhvillimit-t%C3%AB-intervistave-1.pdf>

⁵² Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), Vendim Nr. 137, datë 16.07.2019 “Për miratimin e listës me renditjen e kandidatëve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar”: <http://klp.al/wp-content/uploads/2019/07/Nr.137-Dat%C3%AB-16.07.2019.pdf>

⁵³ RTV Ora News, Përzgjidhen 15 kandidatët për SPAK, përjashtohen krerët e Prokurorisë së Krimeve të Rënda: <https://oranews.tv/article/publikohet-lista-me-kandidatet-spak-ja-emrat-e-15-prokurore>
BalkanWeb, Përjashtohen Prela e Hajdarmataj, KLP: Ja 15 kandidatët e SPAK: <https://balkanweb.com/perjashtohen-prela-e-hajdarmataj-klp-ja-15-kandidatet-e-spak/>

Lista e kandidatëve të renditur për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme kundër Korupsionit dhe Krimin të Organizuar		
1.	Altin Dumani	Prokuror/Prokuroria e Apelit Tiranë
2.	Anton Martini	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda
3.	Elizabeta Imeraj	Drejtuese/ Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë
4.	Arben Kraja	Prokuror/Prokuroria e Përgjithshme
5.	Doloreza Musabelliu	Prokurore/Prokuroria e Krimeve të Rënda
6.	Klodian Braho	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda
7.	Enkeleda Millonaj	Drejtuese/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan
8.	Manjola Kajana	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda
9.	Edvin Kondili	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda
10.	Ened Nakuçi	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda
11.	Elida Kaçkini	Prokurore/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë
12.	Ndini Tavani	Prokuror/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë
13.	Behar Dibra	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda
14.	Anita Jella	Drejtuese/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës
15.	Besnik Muçi	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda

Tabela 3: Lista e 15 kandidatëve të përzgjedhur për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme kundër Korupsionit dhe Krimin të Organizuar, Burimi: Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP): <http://kjp.al/index.php/2019/07/16/keshilli-i-larte-i-prokurorise-shpall-listen-me-15-prokurore-per-spak-lista/>


Ecuria dhe ritmet e procesit të rivlerësimit

Me përfundimin e procesit të intervistimit dhe miratimin e listës me 15 kandidatët për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka përshpejtuar gjatë muajit korrik zhvillimin e seancave dëgjimore dhe marrjen e vendimeve për këto kandidatë (Grafik 5).

KPK po vijon me procesin e rivlerësimit të 15 kandidatëve në garë për ngritje në detyrë në Prokurorinë e Posaçme. Deri në fund të muajit tetor 2019, nga KPK janë konfirmuar në detyrë 10 kandidatë, por për 2 prej tyre vendimi i KPK është ankimuar në KPA (Aneks II). Një kandidat është shkarkuar nga detyra, ndërkohë që për 4 kandidatët e tjerë të cilët janë ende në proces rivlerësimi, akoma nuk janë përcaktuar datat për zhvillimin e seancave dëgjimore.

Gjatë muajve në vijim procesi i rivlerësimit për prokurorët kandidatë për në Prokurorinë e Posaçme nuk është zhvilluar me të njëjtat ritme, duke e bërë ecurinë e tij në kohë edhe më të paparashikueshme. Përkundrajt këtij konteksti, në mbledhjen e mbajtur në datën 25 tetor 2019 KLP ka vendosur që brenda muajit nëntor të kryejë procedurat e emërimit të 8 prokurorëve të posaçëm të cilët janë konfirmuar në të dyja shkallët e rivlerësimit.

Në kushtet kur sipas përcaktimit të Kushtetutës për ngritjen e Prokurorisë së Posaçme duhen të paktën 10 prokurorë, KLP ka parashtruar për diskutim shqyrtimin e opsionit të komandimit të 2 prokurorëve të përkohshëm që kanë kaluar dy shkallët e rivlerësimit, si zgjidhje për plotësimin e numrit 10.



Grafik 5: Ritmet e Seancave Dëgjimore për prokurorët kandidatë në Prokurorinë e Posaçme KKKO (Korrik 2018 – Tetor 2019), Burimi: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (www.kpk.al)

Konkluzione dhe rekomandime

Ashtu si edhe për ngritjen e organeve të tjera të drejtësisë, ecuria e procesit të ngritjes së Gjykatave të Posaçme dhe Prokurorisë së Posaçme, varet së pari nga ritmet e rivlerësimit kalimtar të kandidatëve për prokurorë dhe gjyqtarë.

Për shkak se nuk ka ndonjë parashikim për kohën e kryerjes së seancave dëgjimore për 4 kandidatët e mbetur për ngritje në detyrë në Prokurorinë e Posaçme edhe koha se kur do të ngrihet ky organ mbetet akoma e pacaktuar.

Së dyti, për shkak se Gjykatat e Posaçme dhe Prokuroria e Posaçme janë parashikuar të ngrihen në mënyrë të njëkohshme, me rëndësi kyçe janë edhe rezultatet e procesit të rivlerësimit kalimtar të të gjithë gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda (Shkallës së Parë dhe Apelit).

Meqenëse ashtu si për Prokurorinë e Posaçme, Kushtetuta parashikon se Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë duhet të përbëhet nga së paku 16 gjyqtarë dhe Gjykata e Posaçme e Apelit nga së paku 11 gjyqtarë, në këtë fazë është e pamundur arritja e numrit kushtetues për themelimin e këtyre Gjykatave.

Për të adresuar problematikat që lindin nga numri i pamjaftueshëm i gjyqtarëve duhet që KPK dhe KPA të përshpjetojnë ritmet e rivlerësimit kalimtar të kandidatëve për emërim në Gjykatat e Posaçme pasi rezultatet e vendimeve të marra për gjyqtarët aktualë do të përcaktojnë numrin e vendeve vakante në këto Gjykata.

Nga ana tjetër, për shkak se mbas përfundimit të rivlerësimit të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda vetëm 5 prej tyre janë konfirmuar në detyrë, KLGJ duhet të fillojë procedurat për shpalljen e vendeve vakante dhe të aplikimeve për gjyqtarë në këtë organ.

Aneks I

Statusi i vetting-ut për gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe apelit për Krime të Rënda

Statusi i vetting-ut për gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda					
		Seanca Dëgjimore	Vendimi i KPK	Vendimi i IKP	Vendimi i KPA
1.	Sandër Simoni		Në proces rimerësimi		
2.	Ardit Mustafaj		Në proces rimerësimi		
3.	Irena Gjoka		Në proces rimerësimi		
4.	Daniela Shirka	07.11.2019	Konfirmuar nga KPK		
5.	Etleva Deda		Në proces rimerësimi		
6.	Luan Hasneziri	27.05.2019	Shkarkuar nga KPK		
7.	Flora Hajredinaj		Në proces rimerësimi		
8.	Fran Prendi		Në proces rimerësimi		
9.	Ilirjana Oldashi		Në proces rimerësimi		
10.	Liljana Baku		Në proces rimerësimi		
11.	Marsela Balili		Në proces rimerësimi		
12.	Bib Ndreca		Në proces rimerësimi		
13.	Miliana Muça		Në proces rimerësimi		
14.	Klodian Kurushi		Në proces rimerësimi		
Statusi i vetting-ut për gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Apelit për Krime të Rënda					
1.	Fehmi Petku	02.04.2019	Shkarkuar nga KPK	Vendimi i KPK i pa ankimuar/Ankimuar si subjekt	Në proces
2.	Gjovalin Pernoca	30.07.2019 & 10.09.2019	Shkarkuar nga KPK		
3.	Nertina Kosova	17.07.2018	Konfirmuar nga KPK	Vendimi i KPK ankimuar në KPA	Konfirmuar nga KPA
4.	Dhurata Haveri	25.09.2019	Shkarkuar nga KPK		
5.	Nure Dreni		Në proces rimerësimi		
6.	Saida Dollani	20.06.2019	Konfirmuar nga KPK		
7.	Dhimitër Lara	27.05.2019	Konfirmuar nga KPK		
8.	Sokol Binaj	17.05.2019	Konfirmuar nga KPK		
9.	Gurali Brahimllari	18.06.2019	Shkarkuar nga KPK		
10.	Idriz Mulkurti	12.06.2019	Shkarkuar nga KPK	Vendimi i KPK i pa ankimuar/Ankimuar si subjekt	Në proces
11.	Albana Boksi	04.04.2019	Konfirmuar nga KPK		

Aneks II

Statusi i vetting-ut për 15 kandidatët e renditur për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar

Statusi i vetting-ut për 15 kandidatët e renditur për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar					
		Seanca Dëgjimore	Vendimi i KPK	Vendimi i IKP	Vendimi i KPA
1.	Altin Dumani	30.07.2019	Konfirmuar nga KPK		
2.	Anton Martini		Në proces riveçesimi		
3.	Elizabeta Imeraj		Në proces riveçesimi		
4.	Arben Kraja	13.12.2018	Konfirmuar nga KPK		
5.	Doloreza Musabelliu		Në proces riveçesimi		
6.	Klodjan Braho	25.07.2019	Konfirmuar nga KPK		
7.	Enkeleda Millonai	13.06.2019	Konfirmuar nga KPK		
8.	Manjola Kajana	18.06.2019	Konfirmuar nga KPK	Vendimi i KPK ankimuar në KPA	Në proces
9.	Edvin Kondili	06.06.2019	Konfirmuar nga KPK		
10.	Ened Nakuçi	06.06.2019	Konfirmuar nga KPK		
11.	Elida Kaçkini	16.07.2019	Konfirmuar nga KPK		
12.	Ndini Tavani	07.10.2019	Shkarkuar nga KPK		
13.	Behar Dibra	20.06.2019	Konfirmuar nga KPK		
14.	Anita Jella	04.10.2019	Në proces riveçesimi		
15.	Besnik Muçi ⁵⁴	30.07.2018	Konfirmuar nga KPK	Vendimi i KPK ankimuar në KPA	Në proces

⁵⁴ Kandidati Besnik Muçi u emërua nga Presidenti i Republikës në 15 tetor 2019 gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, duke u përjashtuar nga gara për prokuror në Prokurorinë e Posaçme KKKO.

Aneks III

Kalendari i intervistave me 22 kandidatët për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar

Intervistat me kandidatët për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar	1. Altin Dumani 2. Anita Jella 3. Anton Martini 4. Arben Kraja	8 korrik 2019	Lista e kandidatëve të renditur për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar	<ol style="list-style-type: none"> 1. Altin Dumani 2. Anton Martini 3. Elizabeta Imeraj 4. Arben Kraja 5. Doloreza Musabelliu 6. Klodian Braho 7. Enkeleda Millonaj 8. Manjola Kajana 9. Edvin Kondlli 10. Ened Nakuçi 11. Elida Kaçkini 12. Ndini Tavani 13. Behar Dibra 14. Anita Jella 15. Besnik Muçi
	5. Behar Dibra 6. Besim Hajdarmataj 7. Besnik Muçi 8. Doloreza Musabelliu 9. Donika Prele	9 korrik 2019		
	10. Dorina Bejko 11. Dritan Prençi 12. Edvin Kondlli 13. Elida Kaçkini 14. Elisabeta Imeraj	10 korrik 2019		
	15. Ened Nakuçi 16. Enkeleda Millonaj 17. Enkeleda Xhengo 18. Klodian Braho 19. Manjola Kajana	11 korrik 2019		
	20. Ndini Tavani 21. Vladimir Mara 22. Maksim Sota	12 korrik 2019		

Burimi: Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP): <http://klp.al/wp-content/uploads/2019/06/Kalendari-i-zhvillimit-t%C3%AB-intervistave-1.pdf>

Aneks IV

Hapat ligjorë sipas afateve ushtruar nga KLP lidhur me procedurën e vlerësimit dhe përzgjedhjes të kandidatëve për prokurorë pranë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar

Afatet lidhur me procedurën e vlerësimit të kandidatëve për prokurorë të posaçëm

Zbatimi i hapave nga KLP



Aneks V

Afatet ligjore dhe ecuria e procesit të zgjedhjes së anëtarëve në KLGJ dhe KLP

<i>Ecuria e zgjedhjes së anëtarëve gjyqtarë dhe jo-gjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë</i>	Gusht (2016)	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Janar (2017)	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Janar (2018)	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Hyrja në fuqi e ndryshimeve kushtetuese me Ligjin 76/2016	11 Gusht																												
Hyrja në fuqi e Ligjit 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"			8 Tetor			19 Janar																							
Hyrja në fuqi e Ligjit 115/2016 "Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë"					16 Dhjetor																								
Gjyqtarët dhe prokurorët e interesuar paraqesin kërkesën pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit						realizuar																							
Gjyqtarët/Prokurorët e interesuar i paraqesin Kryetarit të Gjykatës së Lartë/Prokurorit të Përgjithshëm dokumentacionin përkatës						realizuar																							
Kryetari i Gjykatës së Lartë/Prokurori i Përgjithshëm verifikon përmbushjen e kriterëve ligjore						25 Janar																							
Komisioni i Pavarur i Kualifikimit bën rivlerësimin e gjyqtarëve/prokurorëve që kandidojnë pas dorëzimit të shprehjes së interesit dhe dokumentacionit																													
Komisioni i Pavarur i Rivlerësimit i përcjell Kryetarit të Gjykatës së Lartë/Prokurorit të Përgjithshëm listën me emrat e kandidatëve gjyqtarë/prokurorë që e kaluan me sukses procedurën e rivlerësimit.																													
Pas marrjes së listës nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Kryetari i Gjykatës së Lartë/Prokurori i Përgjithshëm thërret Mbledhjen e Përgjithshme të gjyqtarëve/prokurorëve																													
Përfundon procedura e zgjedhjes së anëtarëve gjyqtarë të KLGJ dhe prokurorëve për KLP																													
Përfundon procesi i zgjedhjes së anëtarëve jo-gjyqtarë për KLGJ dhe jo-prokurorë për KLP																													



CSDG Qendra
për Studimin
e Demokracisë
dhe Qeverisjes

Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG)
Tiranë, Nëntor 2019
Adresa: Rruga Kolë Kamsi 11/2, Tiranë
Tel/fax: +35542303007
Mob. +355692049835
E-mail: office@csdgalbania.org
Website: www.csdgalbania.org